

KMDLNj-ja: Arrestimi i Dritan Goxhajt në Tiranë, vazhdim i përndjekjes së ushtarëve të UÇK-së | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL (MAPL) THEMELON GRUP PUNUES PËR KRIJIMIN E RREGULLATIVËS LIGJORE PËR LARGIMIN E KRYETARËVE NË VERI TË VENDIT

QEVERIA KURTI ME UDHËZIM ADMINISTRATIV SYNON LARGIMIN E KRYETARËVE NË VERI



Qeveria e drejtuar nga Albin Kurti, konkretisht ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Elbert Krasniqi, ka themeluar grupin punues i cili do të merret me hartimin e udhëzimit administrativ për caktimin e procedurave për

iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës. Grupi punues ka afat që deri më 1 shtator ta propozojë Draft-udhëzimin për largimin e kryetarëve, që nënkupton shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër

komunat në veri. Ndërsa BE-ja ka thënë haptas se pëlqen dorëheqjen e kryetarëve si një rrugë më të shpejtë drejt zgjedhjeve të reja. Por, si duket, pushteti ka marrë rrugë tjetër, atë të largimit të kryetarëve përmes një iniciative qytetare

AKTUALE



"GRESË, SOT NUK NDIEJ ASGJË VEÇ LIRISË...", LETRA EMOCIONUESE QË JAKUP KRASNIQI I SHKROI VAJZËS NË DITËN E MARTESËS | F. 7

KRASNIQI FTON TË RINJTË E KOSOVËS T'I BASHKOHEN PDK-së | F. 3

OSMANI DEKRETON DHËNIEN E NËNSHTETËSISË SË KOSOVËS PËR SHKRIMTARIN KADARE | F. 3

FILLOJNË PATRULLIMET E PËRBASHKËTA TË POLICISË SË KOSOVËS DHE SHQIPËRISË | F. 3

EKONOMI

AKP-ja MIRATON LISTËN E ASETVE PËR SHITJE PËRMES LIKUIDIMIT SHAL 63 | F. 8

GJITHNJË E MË SHUMË EURO TË FALSIFIKUARA | F. 8

SPORT



KLUBET EVROPIANE NË 'GJAH' PËR FUTBOLLISTËT E KOSOVËS | F. 10

POLICIA E KOSOVËS BËHET ME 250 KAMERA TË TRUPIT, DONACION NGA SHBA-ja | FAQE 5



RASTI I 'KLAN KOSOVËS', SHUMICA E GAZETARËVE E BOJKOTOJNË KONFERENCËN E MINISTRES HAJDARI | FAQE 3



RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Ukraina pajtohet me Kroacinë për përdorimin e porteve për eksportin e drithërave

KIEV, 1 GUSHT - Ukraina dhe Kroacia janë pajtuar për mundësinë e përdorimit të porteve kroate në Danub dhe në Detin Adriatik për eksportimin e drithërave ukrainase. Kështu tha ministri i Jashtëm ukrainas, Dmytro Kuleba, pas takimit me homologun e tij kroat. Rusia këtë muaj është tërhequr nga marrëveshja për drithërat që kishin ndërmjetësuar Kombet e Bashkuara dhe Turqia. Kjo ka pamundësuar që Ukraina - një prodhuese globale e drithërave - të eksportoje në mënyrë të sigurt prodhimet bujqësore nga portet në Detin e Zi teksa lufta po vazhdon. "Tani do të punojmë që të ndërtojmë

rrugë efikase në këto porte dhe të përfitojmë nga kjo mundësi", tha Kuleba pas takimit me Gërliq Radman në Kiev. "Çdo kontribut për ta zhbllokuar eksportin, çdo derë që hapet është një kontribut i vërtetë dhe efektiv për sigurinë ushqimore të botës", tha ai.

Ukraina aktualisht varet nga eksporti përmes rrugëve tokësore në Bashkimin Evropian, por në rrugët alternative përmes Lumit Danub.

Më herët gjatë këtij muaji, Rusia - që ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit 2022 - sulmoi infrastrukturën përgjatë një rruge tokësore që përdoret për eksportimin e produkteve ukrainase.



Franca mohon se po planifikon të ndërhyjë ushtarakisht në Niger

PARIS, 1 GUSHT - Ministrja e Jashtëm e Francës mohoi akuzat e jutës së re në Niger se Parisi po planifikon të kryejë ndërhyrje ushtarake në këtë shtet.

Puçistët në Niamej akuzuan Francën se po planifikonte ndërhyrje ushtarake. "Në kërkim të mënyrave dhe rrugëve për ndërhyrje ushtarake në Niger, Franca në bashkëpunim me disa shtetas të Nigerit kanë mbajtur takim me shtabin e përgjithshëm të Gardës Kombëtare të Nigerit për të marrë autorizimet politike dhe ushtarake të nevojshme", thanë ata në televizionin kombëtar.

"Është e gabuar", tha ministrja e Jashtëm franceze, Catherine Colonna, duke iu përgjigjur këtyre akuzave. Ajo shtoi se



ende ka "mundësi" që presidenti Mohamed Bazoum, që u rrëzua nga pushteti nga ushtria, të rikthehet në udhëheqjen e Nigerit.

"Kjo është e nevojshme sepse destabilizimi është i rrezikshëm për Nigerin dhe fqinjët e tij", tha Colonna.

Bazoum, aleat i Perëndimit, u zgjodh në postin e presidentit të Nigerit dy vjet më parë. Ai u rrëzua nga pushteti më 26 korrik nga Garda elite Presidenciale.

Shefi i kësaj garde, gjenerali Abdourahamane Tiani, e shpalli veten lider të shtetit Sahel, por ky pretendim i tij nuk është njohur ndërkombëtarisht dhe është dënuar. Ndërkombëtarët i kanë dhënë atij afat prej një jave që ta dorëzojë pushtetin.

Të dielën, presidenti i Francës, Emmanuel Macron, u zotua për veprim "të menjëhershëm dhe të pakompromis" nëse qytetarët apo interesat franceze do të sulmohen, pasi mijëra persona protestuan para Ambasadës franceze në Niamej. Disa protestues tentuan të hynin në ndërtesën e ambasadës.

Ministrja Colonna po ashtu tha se protesta ishte "e organizuar dhe jo spontane, ishte e dhunshme, shumë e rrezikshme, dhe u përdorën koktejt molotovi. Aty u valëvitën flamuj rusë dhe u dëgjuan slogan kundër Francës".

Presidenca franceze po ashtu ka njoftuar se Macroni ka biseduar me Bazoumin disa herë si dhe ka zhvilluar biseda edhe me liderët rajonalë.

Gjykatësi refuzon ta bllokojë hetimin zgjedhor të ish-presidentit Trump në Xhorxhia

WASHINGTON, 1 GUSHT - Një gjykatës në shtetin jugor të Xhorxhias të ShBA-së refuzoi të hënën përpjekjet e ish-presidentit Donald Trump për të bllokuar një prokurorë të ndjekë një padi kundër tij për përpjekjet për t'i përmbysur në mënyrë të paligjshme rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2020 në këtë shtet ndaj demokratit Joe Biden.

Trump kishte pohuar se Prokurorja e Qarkut Fulton, Fani Willis në Atlanta, kishte mbikëqyrur një hetim që ishte "konfuz, me të meta dhe, nganjëherë, jokushtetues". Anëtar i Gjykatës së Lartë të

Xhorxhias, Robert McBurney, vendosi se pretendimet e Trumpit ishin "ose të pamjaftueshme ose spekulative".

Gjykatësi tha: "Pretendimet janë të pamjaftueshme sepse, ndërsa të qenit objektiv i një hetimi penal shumë të publikuar, ka të ngjarë të jetë një përvojë e padëshiruar dhe e pakëndshme, asnjë gjykatë nuk ka konstatuar ndonjëherë se ky status i vetëm ofron një bazë që gjykatat të ndërhyjnë më ose ta ndalojnë hetimin".

Gjykatësi McBurney tha se ish-presidenti mund të ngrejë sfida ligjore për hetimin e

Xhorxhias nëse ai akuzohet dhe kur të caktohet një gjyqtar për çështjen.

"Të hamendësosh se si mund të duket situata përpara se të lidhen pikat hetimore, mund të jetë një lojë popullore për median dhe blogosferën", shkroi gjyqtari, "por nuk është një rol i duhur për gjykatat dhe argumentimin ligjor zyrtar".

Me një juri të madhe që po shqyrton çështjen, prokurorja Willis ka sinjalizuar se ajo së shpejti mund ta padisë ish-presidentin Trump dhe një mori ndihmësish të lidhur me përpjekjet e tij për ta ndryshuar rezultatit e



zgjedhjeve të Xhorxhias në vitin 2020.

Në Xhorxhia, Trumpi në fillim të vitit 2021 u telefonoi zyrtarët e zgjedhjeve shtetërore dhe u kërkoi atyre t'i "gjenin" 11 780

vota, një më shumë se diferenca e votave që kishte fituar Bideni, në mënyrë që ta fitonte votën popullore të shtetit dhe 16 votat e tij në Kolegjin Zgjedhor.

Rasti i 'Klan Kosovës', shumica e gazetarëve e bojkotojnë konferencën e ministres Hajdari

PRISHTINË, 1 GUSHT - Gazetarët kanë bojkotuar konferencën e ministres së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta Hajdari, pas revokimit të certifikatës biznese të "Klan Kosovës". Më 14 qershor MINT-i kishte ngritur kallëzim penal ndaj shoqërisë tregtare "Klan Kosova". Kallëzimi penal

është ngritur me "pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërrimi i pronarëve, figuron Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia". Pas kësaj, Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) ka anuluar certifikatën e biznesit të "Klan Kosovës", por më 21 qershor ARBK-ja e kishte

shfuqizuar vendimin, raporton "EO". Megjithatë, një ditë më vonë ARBK-ja e kishte anuluar vendimin e 21 qershorit. Pas ankesës së "Klan Kosovës", Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve ka vendosur më 28 korrik se ARBK-ja kishte "vepruar në përputhje me ligjin kur e



pezulloi certifikatën e biznesit të 'Klan Kosovës'. Ambasada e Francës, e Gjermanisë, e Italisë, e

Britanisë së Madhe, e Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimi Evropian në Kosovë kanë shprehur shqetësim, siç kanë thënë, të thellë, për vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) për pezullimin e licencës së biznesit të televizionit "Klan Kosova".

Osmani dekreton dhënien e nënshtetësisë së Kosovës për shkrimtarin Kadare

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, të martën ka nënshkruar dekretin me të cilin shkrimtarit shqiptar me famë botërore, Ismail Kadare, i jepet nënshtetësia e Republikës së Kosovës.

Sipas presidentes Osmani, dhënia e nënshtetësisë ikonës së letërsisë shqipe, shkrimtarit Ismail Kadare, është nderim për shtetin e Kosovës për krijuesin i cili vazhdimisht është pikë e rëndësishme referimi për shqiptarët kudo në botë. "Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj ndihen të nderuar nga personaliteti i shquar i kombit, shkrimtari ynë i përmasave botërore, Ismail



Kadare, i cili me krijimtarinë e tij ka afirmuar gjuhën, kulturën dhe traditën tonë", ka theksuar presidentja Osmani. Dekreti i nënshtetësisë shkrimtarit Kadare do t'i dorëzohet nga presidentja Osmani gjatë vizitës e cila do të realizohet në Shqipëri në një

periudhë të afërt. Ndryshe, presidentja Osmani në qershor të këtij viti e ka dekoruar shkrimtarin Ismail Kadare me urdhrin "Hasan Prishtina", më i larti të cilin e jep Republika e Kosovës për personalitetet më të shquara të kulturës, artit dhe shoqërisë.

Krasniqi fton të rinjtë e Kosovës t'i bashkohen PDK-së

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka njoftuar se nga sot (e martë) e deri më 30 gusht Rinia Demokratike e Kosovës do ta nisë "Muajin e Rinisë", me aktivitete nga më të ndryshmet, në secilën komunë të Kosovës. Krasniqi i ka ftuar të gjithë të rinjtë të bëhen pjesë e këtyre aktiviteteve për t'i ndarë njohuritë e tyre dhe për ta shfaqur talentin dhe potencialin që kanë. "E-Sports", 'Ball 4 All', 'Co-Play', 'Movie Night', 'Puzzle Battle', ngjarje kulturore dhe



shumë aktivitete të tjera, në çdo komunë, ku mund të shoqëroheni, bashkëbisedoni, ndani njohuritë dhe shfaqni talentin e potencialin tuaj. Ju ftojme të gjithëve, të rinj e të reja, që të na bashkoheni dhe të bëheni pjesë e një muaji përplot me aktivitete", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Fermerët e Shqipërisë hasin probleme me shitjen e grurit, shkak kostot e larta

TIRANË, 1 GUSHT - Në Shqipëri ditët e fundit fermerë të kultivimit të grurit dhe ekspertë të fushës së bujqësisë po shprehin shqetësim në rritje, pasi çmimi i shitjes së grurit në treg është i njëjtë, ose në disa raste nën koston e prodhimit, që sillet nga 26-27 lekë të reja për kg, ose 27 mijë lekë për ton. Çmimi u dyfishua pas agresionit rus në Ukrainë në vitin 2022 dhe mbërriti mbi 500 dollarë për ton, por tregjet u stabilizuan sërish pas arritjes së marrëveshjes mes Rusisë dhe Ukrainës për transportin e drithërave të Ukrainës në Detin e Zi në korrik të po këtij viti. Franc Kaloshi, një fermer në zonën e Lushnjës i cili kultivon grurë që prej 22 vjetësh, tha për "Zërin e Amerikës" se ky është viti i tij më i vështirë. Kostot e prodhimit janë rritur thotë ai dhe çmimi i tregut është nën këto kosto. Situata e viteve të fundit në



bujqësi ka qenë e vështirë si pasojë e krizave që shkaktoi pandemia e koronavirusit, kryesisht agresioni rus në Ukrainë që solli një rritje të ndjeshme të çmimeve në gjithë zinxhirin e furnizimeve në tregjet globale. Para fillimit të krizës çmimi i grurit në bursë ishte pak a shumë i njëjtë me atë që tregtohet sot, por fermerët thonë se kostot e prodhimit janë rritur 25-30 % për

shkak të rritjes së çmimit të imputeve bujqësore, naftës apo fuqisë punëtore, duke mbërritur në kufijtë e çmimit të shitjes. Një prej grumbulluesve të grurit në vend, i lidh me disa faktorë këto kosto të larta. "Ka shumë probleme fermeri te ne, që nga copëzimi i tokës në ngastra, cilësia e pesticideve apo e farërave. Por gruri në gjithë botën subvencionohet që nga Kanadaja,

Amerika, Greqia, Austria, Serbia apo Maqedonia. Nuk ka shtet që nuk e subvencionon grurin, madje subvencionohet fuqishëm. Përndryshe gruri nuk arrin të prodhohet dhe të dalë në treg me sukses. Te ne është bërë një subvencionim për 4 mijë fermerë, por pjesa që nuk ka marrë është e pambrojtur, megjithëse ata që kanë marrë ankohen", u shpreh për "Zërin e Amerikës", Adi Haxhiymeri, kryetar i Unionit të Prodhuesve të Miellit. Një vit më parë qeveria shqiptare për herë të parë njoftoi subvencionimin me 30 mijë lekë të reja për ha për kultivimin e grurit që iu shtuan disa skemave të mbështetjes së fermerëve me naftë. Por kjo nuk ndikoi në një rritje të ndjeshme të sipërfaqes së grurit në vend. Autoritetet thanë për "Zërin e Amerikës" se çmimi është produkt i kërkesës dhe ofertës në tregjet

ndërkombëtare dhe se ndërhyrjet financiare dhanë efektet në konsolidimin e sipërfaqes së kultivimit të grurit. Ditët e fundit në bursë ka një trend rritës të çmimit të grurit, nga 250 në 300 dollarë për ton, si pasojë e tërheqjes së Rusisë nga marrëveshja që i lejonte Ukrainës eksportin e drithërave në Detin e Zi. Kjo mund të sjellë një situatë të favorshme për fermerët shqiptarë pasi mund ta shesin grurin me një çmim më të lartë. Sipërfaqja e grurit, sipas të dhënave të Instatit, është zvogëluar ndjeshëm prej viteve 2000, me 62%, dhe me 21% vetëm në 5 vitet e fundit dhe prodhimi vendas plotëson gjysmën e nevojave. Shkalla e subvencioneve në bujqësi, edhe pse ka njohur rritje këto vite, sërish është e pamjaftueshme sipas ekspertëve, për të ndikuar në rritjen e sipërfaqeve të mbjella me grurë.

Fillojnë patrullimet e përbashkëta të policisë së Kosovës dhe Shqipërisë

Prishtinë, 1 gusht - Me qëllim të parandalimit të aksidenteve dhe rritjes së sigurisë në trafikun rrugor, Policia e Kosovës dhe Policia e Shqipërisë kanë hartuar memorandum bashkëpunimi për patrullime të përbashkëta të dy policive

rrugore në territorin e Republikës së Shqipërisë. Referuar numrit të shtetasve nga Kosova që shkojnë për pushime në Shqipëri dhe numrit të madh të mjeteve që qarkullojnë në akset rrugore në mes të dy vendeve, është

vlerësuar i suksesshëm ky patrullim i përbashkët. Ky patrullim ka për synim rritjen e efikasitetit në sigurinë rrugore, parandalimin e kundërvajtjeve dhe aksidenteve si dhe krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik.





MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL (MAPL) THEMELON GRUP PUNUES PËR KRIJIMIN E RREGULLATIVËS LIGJORE PËR LARGIMIN E KRYETARËVE NË VERI TË VENDIT

Qeveria Kurti me udhëzim administrativ synon largimin e kryetarëve në veri

Qeveria e drejtuar nga Albin Kurti, konkretisht ministri i Administrimit dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Elbert Krasniqi, ka themeluar grupin punues i cili do të merret me hartimin e udhëzimit administrativ për caktimin e procedurave për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës. Grupi punues ka afat që deri më 1 shtator ta propozojë Draft-udhëzimin për largimin e kryetarëve, që nënkupton shpalljen e zgjedhjeve të reja në katër komunat në veri. Ndërsa BE-ja ka thënë haptas se pëlqen dorëheqjen e kryetarëve si një rrugë më të shpejtë drejt zgjedhjeve të reja. Por, si duket, pushteti ka marrë rrugë tjetër, atë të largimit të kryetarëve përmes një iniciative qytetare

Lirim GEÇI

Prishtinë, 1 gusht - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka marrë vendim të hënën për caktimin e një grupi punues që do ta hartojë udhëzimin administrativ për caktimin e procedurave për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave në veri të Kosovës. Bashkimi Evropian (BE) ka thënë haptas që pëlqen dorëheqjen e kryetarëve si një rrugë më të shpejtë drejt zgjedhjeve të reja. Por, si duket, pushteti ka marrë rrugë tjetër, atë të largimit të kryetarëve përmes një iniciative qytetare. Në dokumentin e nënshkruar nga ministri i MAPL-së, Elbert Krasniqi, ky grup do të kryesohet nga Besim Myrtezani, ndërsa anëtarë do të jenë Xhevat Tava, Fetije Begolli dhe Flurim Arifi.

Grupi i emëruar do ta ketë përgjegjësinë për "hartimin e udhëzimit administrativ për caktimin e procedurave dhe

afateve për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave". Afati që i është dhënë këtij grupi është deri më 1 shtator. Kujtojmë se Qeveria e Kosovës ka deklaruar gatishmërinë e saj për përgatitjen e bazës ligjore për organizimin e zgjedhjeve të reja. Megjithatë, kryeministri Albin Kurti dhe zëvendëskryeministri Bislimi kanë pasur deklarata të çuditshme duke lënë të nënkuptojë se zgjedhjet do të mbaheshin vetëm pas heqjes së masave ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës. Këto masa ndëshkuese nuk janë hequr edhe më tej. Zëvendëskryeministri Bislimi ishte cituar duke thënë se "Kosova nuk duhet të shpallë zgjedhje në veri pa u hequr sanksionet nga BE-ja".

Edhe më tej nuk dihet nëse serbët e vendit do të marrin pjesë në zgjedhjet e reja.

Pushteti ende nuk ka treguar se çfarë do të ndodhte pas udhëzimit administrativ.

BE-ja bën thirrje të shpallen

zgjedhjet e parakohshme në veri

Bashkimi Evropian (BE) ka bërë thirrje që zgjedhjet e parakohshme në veri të Kosovës të shpallen sa më shpejt në mënyrë "që t'i jepet fund krizës aktuale".

Një zyrtar i BE-së ka bërë me dije se BE-ja mbetet e shqetësuar për tensionet në veri të Kosovës dhe vazhdon të bëjë thirrje për deeskalim të menjëhershëm nga të dyja palët. "Për më tepër dhe për t'i dhënë fund krizës aktuale, zgjedhjet e parakohshme duhet të shpallen sa më shpejt në të katër komunat dhe të organizohen në mënyrë plotësisht gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë me pjesëmarrjen e plotë dhe të pakushtëzuar të serbëve të Kosovës. BE-ja ka bërë kërkesa specifike për depërshkallëzimin për të dyja palët (sipas deklaratës së përfaqësuesit të lartë në emër të BE-së të datës 3 qershor, propozimit të përfaqësuesit të lartë për të dyja palët më 22 qershor dhe konkluzioneve të Këshillit Evropian të 30 qershor).

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Prishtinë, 31.07.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutit të Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 mars 2019), neni 72 të Ligjit Nr.05/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe duke u bazuar në paragrafin 1.4 të nenit 8 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nsjerr:

VENDIM

- Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për caktimin e procedurave për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave, me këtë përbërje:
 - 1.1 Besim Myrtezani, kryesues;
 - 1.2 Xhevat Tava, zv. kryesues;
 - 1.3 Fetije Begolli, anëtar;
 - 1.4 Flurim Arifi, anëtar;
 - 1.5 Përfaqësues nga Zyra e Presidentes së Kosovës, anëtar;
 - 1.6 Përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit të Kosovës, anëtar;
 - 1.7 Përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, anëtar;
 - 1.8 Përfaqësues nga Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar;
 - 1.9 Përfaqësues nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, anëtar;
 - 1.10 Përfaqësues nga Komunitet e Kosovës, anëtar;
 - 1.11 Përfaqësues nga Shoqëri Civile, anëtar.
- Grupi punues, në procesin e hartimit të projekt-Udhëzimit Administrativ, mbështeten nga:
 - 2.1 Kabineti i Ministrit të MAPL;
 - 2.2 Zyra e BE-së në Kosovë;
 - 2.3 Përfaqësues nga Ambasadat e Akredituara në Republikën e Kosovës;
 - 2.4 OSBE.
- Grupi Punues është përgjegjës për hartimin e Udhëzimit Administrativ për caktimin e procedurave dhe afateve për iniciativën e qytetarëve për largimin e kryetarëve të komunave.
- Grupi punues duhet ta finalizojë Projekt-Udhëzimit Administrativ, dhe ta procedojë të Zyra e Sekretariatit të përgjithshme të MAPL-së deri me datën 01 Shtator 2023.
- Grupi punues do përkrahët nga zyrtari i sekretarisë që do merret me agjendën, aranzhimet e takimeve, procesbalet dhe detyra të tjera rreth këtij procesi. Zyrtari i sekretarisë caktohet z. Gafur Sllamnika.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Elbert Krasniqi
Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Vendimi i dërgohet:
- Zv. Sekretar i Përgjithshëm të MAPL-së;
- Zyrtarëve të caktuar në vendin;
- Udhëheqësve të Njësi Organizative;
- Arkivi të MAPL-së;

Në deklaratën e 3 qershorit, të rënë dakord nga të 27 shtetet anëtare, BE tha qartë se ishte e gatshme të merrte masa të vendosura në rast të dështimit për të depërshkallëzuar, është thënë në përgjigjen e BE-së për

"Dukagjinin". Më tutje është thënë se BE-ja mirëpret njoftimin e Qeverisë së Kosovës për një reduktim të menjëhershëm prej 25-përqindësh të pranisë së policisë në dhe përreth ndërtesave

KMDLNj-ja: Arrestimi i Dritan Goxhajt në Tiranë, vazhdim i përndjekjes së ushtarëve të UÇK-së

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka reaguar pas arrestimit në Tiranë të ish-ushtarit të UÇK-së, Dritan Goxhaj. Ky këshill ka vlerësuar se arrestimi i Goxhajt është në vazhdim të përndjekjes së ushtarëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale. "Sipas mediave shqiptare, Policia e Shtetit, me urdhër të së ashtuquajturës Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) arrestoi ish-ushtarit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Dritan Goxhaj, shtetas i Shqipërisë sikur që bastisi edhe objektin e banimit. Po këtë lajm e konfirmoi më vonë edhe zëdhënësja e DhSK-së duke shprehur mirënjohje për policinë shqiptare. Tani, Dritan Goxhaj mbahet në objektin e Policisë së Shtetit duke pritur ekstradimin, fillimisht në Kosovë e pastaj në Qendrën e Paraburgimit në Hagë. Dritan Goxhaj është arrestuar në dyshim të pengimit të administrimit të drejtësisë, rrezikimit të dëshmitarëve të mbrojtur dhe pengim të personit zyrtar në kryerjen e detyrës. Gjithnjë sipas asaj që thuhet nga informatat e stercensuruara të së ashtuquajturës DhSK-së, i arrestuari Dritan Goxhaj në një shkrim paska bërë publik emrin e një dëshmitareje që ka statusin e mbrojtur e cila qenka zyrtare e lartë në njërin nga ministritë e qeverisë Kurti 2 sikur që, gjithashtu, paska rrezikuar edhe tre dëshmitarë të tjerë të "mbrojtur" të cilët, sipas KMDLNj-së, para se të shkojnë për të dëshmuar, kanë qenë të ekspozuar në mediet elektronike të Kosovës duke dhënë

intervista paragjyquese ndaj të akuzuarve, ende pa filluar procesin", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Sipas KMDLNj-së, tash po të njëjtit dëshmitarë të "mbrojtur", fjalët dhe dëshmitë që i kanë thënë në intervista publike, po i përsëritin në një cilësi tjetër, si "dëshmitarë të mbrojtur". "Pikërisht janë DhSK-së, (më parë të Kazakistanit se të Kosovës) që po i rrezikojnë dëshmitarët e mbrojtur, madje në mënyrë të dyfishtë. E para se duke arrestuar apo intervistuar rrezikues të 'dëshmitarëve të mbrojtur', po i rrezikon edhe nga ata kundër të cilëve dëshmojnë dhe, e dyta po i rrezikon edhe nga ata që po arrestohen apo intervistohen si 'kërcënues'. Kjo, në fakt nuk paraqet asnjë mbrojtje për këta dëshmitarë por i vë në situatë të pëllumbave të argjilit në një hapësirë të pambrojtur ku, pa asnjë problem mund të qëllohen nga disa anë. Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve të mbrojtur deri më tani 100 për qind është menaxhuar nga ndërkombëtarët dhe 100 për qind është dekonspiruar nga ndërkombëtarët të cilët kanë përgjegjësi që nuk iu kanë ofruar siguri dhe mbrojtje efektive. Ndërkombëtarët kanë siguruar mbrojtje vetëm deri në kohën kur kanë përfunduar intervistimet nga prokurori dhe gjykata dhe, pasi është shqiptuar dënimi, i kanë lënë në mëshirën e fatit. Fillimisht kanë dhënë premtime të mëdha për të siguruar dëshmi; nga një shumë e madhe e parave, lirimi nga vuajtja e dënimit, ndërrimi i identitetit dhe strehimi (azili) në një vend të



tretë për ta dhe familjarët e ngushtë", është thënë në këtë reagim. Më tutje, në reagimin e KMDLNj-së është thënë se deri më tani vetëm një ekspert ndërkombëtar ka dëshmuar në një proces publik, kurse të tjerët kanë dëshmuar në seanca të mbyllura apo private. "Për një pjesë e opinionit në Kosovë, të gjithë këta dëshmitarë 'të mbrojtur' janë dëshmitarë që dihen, me emër dhe mbiemër. E ashtuquajtura DhSK, në mungesë të transparencës, llogaridhënies dhe monitorimit nga ndonjë institucion apo organizatë e pavarur, po përdorë metoda brutale për kërcënim të gjithë atyre që nuk pajtohen me punën në errësirë informative të kësaj Gjykate, që kanë qëndrim kritik dhe të argumentuar, që kanë qëndrim antiracist ndaj kësaj gjykate thellësisht raciste (të gjithë të arrestuarit, të akuzuarit dhe të dënuarit janë shqiptarë dhe ish-ushtarë të UÇK-së apo shqiptarë të shteteve tjera), Dritan Goxhaj shtetas i Shqipërisë dhe Pjetër

Shala, shqiptar, shtetas i Mbretërisë së Belgjikës. Po kesi qëndrimi kishte regjimi represiv i ish-Jugosllavisë dhe Serbisë që akuzonin dhe dënonin shqiptarë me një ligj, me metoda të UDB-së që, sipas nevojës zgjatej si llastiku, Ligji i propagandës armiqësore", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Ky këshill ka theksuar se në Kosovë janë mbajtur peng persona të caktuar nga Gjykata Speciale kinse për pengim të drejtësisë. Në këtë kontekst, KMDLNj-ja ka përmendur rastin e Dritan Lajçit, i cili është shpallur i pafajshëm. "Sot në Kosovë ka shumë të intervistuar për kinse pengim të administrimit të drejtësisë dhe frikësim të dëshmitarëve e që mbahen peng i kërcënimit për vite të tëra siç ishte rasti i Dritan Lajçit i cili u shpall i pafajshëm pasi u mbajt peng në stres dhe presion thuaja 4 vjet e gjysmë nga kjo Gjykatë e Specializuar kundër UÇK-së, kundër shqiptarëve dhe kundër të drejtave të njeriut. Kush do të kompensojë vuajtjet

shpirtërore dhe fizike të Dritan Lajçit, degradimin në karrierë dhe dëmtim të rëndë të reputacionit aq më parë që nuk ka as kërkimfalje formale nga inkuizitorët (përndjekësit) e Lajçit e që po të njëjtin veprim po e vazhdojnë ndaj të tjerëve që i ka futur në listën e zezë të saj. Kush, deri më sot dha përgjegjësi për rrjedhjen (shitjen) e dokumenteve të ndjeshme nga kjo Gjykatë pas së cilës u arrestuan dhe u dënuan me dënime drakonike, Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati?!", është thënë në këtë reagim.

KMDLNj-ja ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës, si "themelues" i Gjykatës Speciale, të kërkojë raport, përgjegjësi dhe llogaridhënie nga kjo gjykatë. "Kuvendi i Kosovës, si 'themelues' i kësaj gjykate, në vend se të kërkojë raport, përgjegjësi dhe llogaridhënie, me mosveprim dhe mungesë të guximit, po bëhet pjesë e eskortës sadiste ndaj të arrestuarve dhe të intervistuarve që po mbahen peng nga burokratët që, në emër të drejtësisë, në mënyrë flagrante po i shkelin të drejtat e njeriut të personave të privuar nga liria! Kërkimi i drejtësisë për viktimë që do të duhej të ishte mision i vetëm i çdo gjykate nuk nënkupton krijimin e viktimave tjera, pa siguruar prova apo duke siguruar "prova" nga ata që bënë krime të tmerrshme në Kosovë; ushtria, policia dhe paramilitarët nga Serbia që i nënshtroheshin një urdhri politik nga kreu më i lartë politik dhe ushtarak i Serbisë", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Policia e Kosovës bëhet me 250 kamera të trupit, donacion nga ShBA-ja

PRISHTINË, 1 GUSHT (ER) - Të martën është bërë pranimi i donacionit për kamerat e trupit të Policisë së Kosovës, i cili është projekt i përbashkët ndërmjet INL-DOS dhe ICITAP-DOJ, i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë. Gazmend Hoxha, drejtor i Policisë së Kosovës, e ka falënderuar ambasadën e ShBA-së për përkrahjen e vazhdueshme, derisa ka bërë

me dije se donacion kanë marrë 250 kamera të trupit. "Si polici mundohemi t'i kryejmë detyrat me nder dhe respekt, bazuar në ligjin dhe standardet më të larta demokratike", ka thënë Hoxha. Drejtori Hoxha ka thënë se 250 kamerat e trupit për Policinë e Kosovës do të jenë të dobishme si dhe do të rritin llogaridhënien dhe transparencën e punës. "Kjo



do të ndikojë edhe në rritjen e besimit të qytetarët", ka thënë Hoxha. Më tutje, ai ka treguar se një

pjesë e këtyre kamerave do të shpërndahen në veri të vendit. "Një pjesë e tyre do të shpërndahet edhe në veri të Kosovës nga njësitë tona që punojnë në atë pjesë. Ajo çfarë ne duam si polici, duam që publiku, komuniteti të ketë besim në Policinë e Kosovës, dhe këto kamera besoj se do të ndikojnë pozitivisht në ngritjen e besimit të

qytetarëve të policia jonë", ka thënë Hoxha. Ndërsa ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se donacioni është dëshmi e mbështetjes së Policisë së Kosovës. Hovenier ka theksuar se kamerat do ta përmirësojnë llogaridhënien e policëve dhe do të dëshmojnë me paanshmëri për rastet. Ai është shprehur krenar që ShBA-ja e jep këtë donacion që shënon programin e parë të kamerave të trupit në Kosovë.

komunale në veri të Kosovës, si dhe përkushtimin për uljen e mëtejshme të shkallës pas vlerësimeve të përbashkëta të sigurisë nga Policia e Kosovës, EULEX-i dhe - nëse të përshtatshme - KFOR. "Këta janë hapa në drejtimin e duhur, por nevojiten hapa të mëtejshëm. BE-ja i kërkoi Kosovës që të veprojë në mënyrë joshkallëzuese dhe t'i pezullojë menjëherë operacionet e policisë brenda dhe në afërsi të katër ndërtesave komunale në veri të Kosovës. Katër kryetarët e komunave duhet t'i kryejnë përkohësisht detyrat e tyre në objekte të ndryshme nga

ndërtesat komunale", është thënë në përgjigje. BE-ja ka theksuar se është thelbësore që të ketë zbatim të shpejtë të marrëveshjes për rrugën e normalizimit të marrëdhënieve dhe aneksit të zbatimit të saj, duke përmendur edhe themelimin e "Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe". Tensionet në Kosovë janë rritur pas hyrjes së kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat e komunave në veri të Kosovës - Zvečan, Leposaviq, dhe Zubin Potok - të banuara me shumicë serbe. Komuniteti serb dhe Lista Serbe, partia më e madhe e

serbëve në Kosovë, i kanë bojkotuar zgjedhjet e prillit, por as nuk i kanë pranuar kryetarët e rinj. Tensionet kanë kulmuar edhe me dhunë në mes të protestuesve dhe pjesëtarëve të misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR. Komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar nga Kosova dhe Serbia t'i ulin tensionet dhe të ulen në tavolinën e negociatave. Më 10 korrik Kosova ka arritur marrëveshje me BE-në për ulje të tensioneve dhe në të është përfshirë edhe mbajtja e zgjedhjeve të reja në veri. Mirëpo, së fundi, kryeministri i Kosovës,

Albin Kurti, ka thënë se zgjedhje nuk mund të ketë pa shtensionim të plotë të situatës në veri. "Në do të sigurohem që kjo përvojë e re që do ta kemi me ndërprerjen e mandatit të këtyre kryetarëve në veri ta ketë mbështetjen dhe garancitë ligjore dhe procedurale. Pra, duhet të sigurohem që procesi i tillë të jetë aq i sigurt saqë të jetë i pasfidueshëm në kuptimin legal dhe juridik", ka thënë Kurti në një konferencë për medie. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka thënë se zgjedhjet e parakohshme mund të

zhvillohen nëse 20 për qind e votuesve në një komunë nënshkruajnë një peticion për largimin e kryetarit të asaj komune. Ky peticion, sipas Krasniqit, më pas do të dërgohej në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), që do ta verifikonte atë dhe më pas do të niste një referendum me pyetjen se a duhet të shkarkohet kryetari. Këtë qëndrim Krasniqi e ka artikuluar me vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e rregullativës ligjore për largimin e kryetarëve dhe mbajtjen e zgjedhjeve në veri të Kosovës.

Vazhdon sinjalizimi i rrugëve në Prizren

PRIZREN, 1 GUSHT - Sipas kritereve të infrastrukturës moderne është duke u bërë sinjalizimi horizontal i rrugëve "Besim Telaku", "Ersan Mazreku" dhe "Ramadan Thaqi" në

Prizren me vija të bardha të plota dhe të ndërprera, pastaj sinjalizimi i vendkalimeve për këmbësorë dhe sinjalizimi për ngadalësim të shpejtësisë së automjeteve.

Komuna ka njoftuar se realizimi i këtij projekti ngrit nivelin e sigurisë së të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion në këto rrugë të rëndësishme të qytetit tonë.



Nëntë të lënduar nga tri aksidente gjatë 24 orëve në rajonin e Prizrenit

PRIZREN, 1 GUSHT - Gjatë 24 orëve të fundit tri aksidente trafiku me lëndime të rënda trupore kanë ndodhur në rajonin e Prizrenit. Policia ka bërë me dije se dy aksidente kanë ndodhur në Suharekë dhe një tjetër në Prizren. Aksidenti i parë në Suharekë ka ndodhur derisa një femër ishte duke drejtuar veturën me targa vendore dhe godet një automjet tjetër me targa vendore. Si pasojë e aksidentit lëndime trupore marrin vozitësi i automjetit dhe dy pasagjeret, meshkuj kosovarë, të cilët kanë pranuar tretman mjekësor. Aksidenti i dytë ka ndodhur në Prizren dhe janë përfshirë katër vetura. Si pasojë, lëndime

trupore kanë pësuar katër persona kosovarë/e. Pas tretmanit mjekësor dy prej viktimave janë liruar, ndërsa njëra prej tyre ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe është dërguar në QKUK në Prishtinë për trajtim të mëtutjeshëm. Aksidenti i tretë ka ndodhur po dje në Suharekë rreth orës 18:30 mes të dy automjeteve me ngasës meshkuj kosovarë. Përveç dëmeve materiale, lëndime trupore ka pësuar një nga drejtuesit dhe një pasagjer të cilët kanë pranuar tretman mjekësor në spitalin e Prizrenit, ku njëri prej tyre është dërguar në QKUK për tretman të vazhdueshëm.



Diskutohet për raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën e Podujevës për vitin fiskal 2022



PODUJEVË, 1 GUSHT - Kuvendi i komunës së Podujevës ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të cilën e ka udhëhequr kryesuesi Hilmi Hoxha. Në të ishte i pranishëm edhe kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, nënkryetarja Marigona Lahu, anëtarët e ekzekutivit, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-së dhe media.

Gjatë mbledhjes u dha informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSBB për vitin 2022 nga kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi. Gjithashtu, u diskutua për raportin e auditorit të përgjithshëm për komunën e Podujevës për vitin fiskal 2022 dhe për raportin financiar të komunës së Podujevës për periudhën janar-qershor 2023.

Kamenica, burim i personaliteteve të shquara

KAMENICË, 1 GUSHT - Të shoqëruar nga i pari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, me një ftesë të veçantë, personalitete të shquara nga Kamenica janë mbledhur së bashku. Në një tryezë të përbashkët, në fshatin Tugjec, figura të rëndësishme kanë diskutuar e

kanë ndarë përvojat e tyre profesionale të cilat padyshim se do të shërbejnë si udhërrëfyes në të ardhmen. Një organizim i tillë është bërë në kuadër të "Kamenica Summer Fest", në shenjë falënderimi dhe mirënjohje për kontributin e këtyre personaliteteve nga e kaluara e

deri më sot, ku biseda produktive, këshilla e rekomandime që transmetonin vlera të çmuara për të mirën e përbashkët, u mirëpritën nga kryetari i komunës, duke e falënderuar gjithsecilin për angazhimin e tyre në zhvillimin e komunës dhe vendit.



Ministria e Mjedisit pezullon pëlqimin mjedisor për ndërtimin e inceneratorit në Ferizaj, shkarkohen dy komisione

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar të martën se kanë pezulluar pëlqimin mjedisor për ndërtimin e një inceneratori për trajtimin e mbeturinave në qytetin e Ferizajt.

Në një konferencë për medie, ai ka thënë se ministria që drejton në dhjetor të vitit të kaluar i kishte lëshuar pëlqimin mjedisor një kompanie për incenerator në Varosh të Ferizajt, që nënkupton djegien e rreth 100 mijë ton mbeturinave në vit. Sipas tij, kjo është bërë pa i përfillur ligjet dhe pa konsultim me ekspertë të ambientit. "Në maj befasi na vjen

një kompani dhe thotë kemi marrë pëlqim nga ju për trajtim termik të mbeturinave dhe po ashtu kemi marrë leje ndërtimore në Komunën e Ferizajt për të ndërtuar një gjenerator. Kam kuptuar që në dhjetorin e vitit që shkoi ka pasur të lëshuar pëlqim mjedisor për incenerator në Varosh të Ferizajt, që nënkupton djegien e rreth 100 mijë ton mbeturinave në vit", ka deklaruar ministri Aliu para gazetarëve.

Ai ka thënë se duke njohur gjeografinë e vendit e di që është vështirë për të gjetur një lokacion të tillë në vendin tonë, i cili nuk ka për të pasur ndikim te qytetarët. "Pas vizitës në terren dhe takimit me qytetarët, e kemi kuptuar se askush nga qytetarët nuk e ka ditur se aty planifikohet të

ndërtohet një gjenerator. E kemi shqyrtuar edhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis. Aty thuhet se objekti është 3 mijë metra larg vendbanimeve gjë që ishte e pamundur pasi janë më pak se 700 metra", ka thënë Aliu. Ai ka theksuar se kanë nisur një proces të auditimit dhe janë bërë matjet gjeodezike, ku më pas kanë kuptuar se ky raport nuk ka të bëjë asgjë me realitetin. "Kemi marrë vendim që kjo të shkojë në auditim e aty më pas dalin edhe shkelje të tjera. Fatmirësisht përfundoi si rast deri tani me pezullimin e pëlqimit mjedisor", është shprehur Aliu. Ndërsa zëvendësministri Avni Zogiani ka bërë me dije se janë shkarkuar dy komisione lidhur me këtë rast.



Jep dorëheqje zëvendësministrja e Arsimit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 GUSHT - Zëvendësministrja e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë e Inovacionit (MASHTI), Edona Maloku-Bërdyna, ka bërë me dije se ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, për t'iu kthyer punës



akademike në arsim e shkencë. "Ju njoftoj se dje, më 31 korrik 2023, kam përmbyllur rrugëtimin tim si zëvendësministre për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion në Qeverinë e Kosovës. Për shkaqe subjektive, e kam të pamundur të vazhdoj më tej angazhimin tim në këtë detyrë dhe rrjedhimisht, i kam dorëzuar dorëheqjen time kryeministrit Kurti", ka shkruar Maloku-

Bërdyna në "Facebook".

Ajo ka thënë se takimin përshëndetës me kryeministrin e zhvilluan në frymë shumë pozitive siç ka qenë edhe bashkëpunimi me të dhe të gjithë kolegët e qeverisë gjatë kësaj detyre. "Kryeministrin Kurti e falënderoj për zemërsisht për besimin e dhënë, mbështetjen dhe afërsinë e treguar në këto dy vite shërbimi. Në Qeverinë e Kosovës kam punuar me përkushtimin maksimal personal e profesional. Jam krenare sidomos për kontributin e dhënë në zhvillimin e fëmijërisë së hershme, rritjen e përfshirjes së vajzave/grave në fushat e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë e matematikës (STEM), avancimin e gjithëpërfshirjes në arsim, zhvillimin e shkencës e inovacionit dhe urëzimin e bashkëpunimeve rajonale e ndërkombëtare", ka shkruar ajo, duke bërë me dije se po i kthehet punës sime akademike, për të vazhduar aty kontributin e saj në arsim e në shkencë.

"Gresë, sot nuk ndiej asgjë veç lirisë...", letra emocionuese që Jakup Krasniqi i shkroi vajzës në ditën e martesës

PRISHTINË, 1 GUSHT - Vajza e Jakup Krasniqit, i cili po mbahet në paraburgim në Hagë, Gresa, ka publikuar një letër mjaft prekëse të babait të saj me rastin e martesës. Me një fotografi të bashkëngjitur ku shihet Gresa dhe burri i saj, përballë një fotografie të Krasniqit, të ngjitur në mur, ajo ka publikuar vargjet nga babai i saj.

"Gresë!
Kur një ditë një padrejtësi tinëzare
Mi humbi shpresat për lirinë
njerëzore
Fejesa juaj në znanin' e Padrejtësisë
Me bëri të jetoj me dashurinë e Lirisë!

Gresë!
Sot nuk ndiej asgjë veç Lirisë
Se po martohesh me Sadikun e Dardanisë
Urimet e mija janë si gëzimi i fëmisë
Që gjak e jetë i jep vetëm Lumturisë!"

Jakup Krasniqi, 1 gusht 2023



Mehaj priti në takim kadetët e FSK-së që studiojnë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka pritur në takim kadetët tanë të cilët studiojnë në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. Që nga marrëveshja bilaterale në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, tashmë janë duke studiuar gjithsej nëntë kadetë

në Akademinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë - Fakultetin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (shkenca ushtarake) duke përfaqësuar Republikën e Kosovës.

Nga këta studentë, në vitin e dytë janë katër kadetë të cilët pritet të diplomojnë në vitin

2024, si gjenerata e parë nga Kosova, ndërsa në vitin e parë janë pesë kadetë.

Gjatë këtij viti janë përzgjedhur edhe dhjetë kadetë të tjerë që pritet t'i fillojnë studimet në tetor të këtij viti në tri drejtime të ndryshme.



Gjithnjë e më shumë euro të falsifikuara

Në gjysmën e parë të vitit 2023 në qarkullim janë regjistruar më shumë para të falsifikuara sesa në tri vitet e fundit. Cilat janë shkaqet?

PRISHTINË, 1 GUSHT - Kartëmonedhat 200 euro nuk janë në fakt shumë të njohura dhe nuk përdoren shpesh. Në shumë pika karburanti dhe në shumë dyqane të shitjes me pakicë nuk i pranojnë fare. Edhe më rrallë përdoren kartëmonedhat prej 500 eurosh. Për këtë arsye duhet pasur kujdes të veçantë kur persona të panjohur paguajnë me tufa të mëdha të kartëmonedhave të tilla. Dhe pikërisht me kartëmonedhat prej 200 dhe 500 eurosh janë shtuar falsifikimet e parave në Gjermani në gjysmën e parë të këtij viti. Dëmi i shkaktuar prej 2.9 milionë eurosh në vetëm gjashtë muaj e ka tejkaluar vlerën e të gjithë vitit të kaluar (2.7 milionë euro), ka njoftuar Bundesbank.

Një numër rekord eurosh të falsifikuara

Sipas të dhënave nga Bundesbank, policia gjermane, shitësit me pakicë dhe bankat tërhuqën nga qarkullimi 26 690 kartëmonedha të falsifikuara midis janarit dhe qershorit të vitit 2023. Hera e fundit që u regjistrua një numër më i madh falsifikimesh ishte në gjysmën e parë të vitit 2020, kur në qarkullim janë kapur 34 118 kartëmonedha të falsifikuara. Falsifikimi i dy kartëmonedhave më të vlefshme është rritur ndjeshëm në krahasim me gjysmën e dytë të vitit 2022. Në rastin e kartëmonedhave 200 euro në numrin e përgjithshëm të falsifikimit, ka një rritje prej 15-

përqindësh - pas nëntë për qind në gjashtë muajt e mëparshëm. Ndërsa numri i kartëmonedhave të falsifikuara 500 euro në të njëjtën periudhë pothuajse u katërfishua, nga 554 në 2 178 copë. Kështu, kartëmonedha ngjyrë vjollcë, të cilën bankat qendrore të Eurosistemit nuk e kanë shtypur që nga fillimi i vitit 2019, ka shënuar një rritje të dukshme të falsifikimeve. "Unë nuk do të flisja për ndonjë tendencë në këtë moment", tha anëtari i bordit të Bundesbank, Burkhard Balz, në një deklaratë për agjencinë e lajmeve dpa. "Megjithatë, ne i ndjekim këto dukuri me shumë kujdes". Sipas të dhënave nga Bundesbank, kartëmonedha 50 euro është ende kartëmonedha më e falsifikuar, e cila përbën pothuajse 40 për qind të të gjitha falsifikimeve të parave në Gjermani. Ndërsa 20 për qind të falsifikimeve në gjysmën e parë të vitit ishin kartëmonedha 20 euro.

Kartëmonedha false për të blerë mallra luksi

Cilësia e kartëmonedhave 200 dhe 500 euro, theksojnë ekspertët e Bundesbank, nuk është dhe aq e mirë. Ato ngjajnë me faturat e thjeshta "Movie Money" ose "Prop copy" që mund të gjenden në internet si para për lojërë ose rekuizita filmash, thotë Balz. Sipas policisë, në disa raste me kartëmonedha të tilla janë paguar bizhuteri, flori, ora



luksoze dhe makina të shtrenjta. Anëtari i bordit të Bundesbank, Balz, nuk sheh arsye për shqetësim për shkak se shifrat janë ende relativisht të ulëta: "Pavarësisht rritjes së numrit të këtyre kartëmonedhave me rreth dhjetë për qind, situata me falsifikimin në thelb nuk ka ndryshuar shumë". Sipas tij, në Gjermani ka ende një rrezik të ulët kur bëhet fjalë për mashtrimet e kartëmonedhave false. Shikuar nga të dhënat statistikore, në gjysmën e parë të këtij viti janë regjistruar vetëm gjashtë kartëmonedha të falsifikuara për 10 mijë banorë.

Kujdes!

Kartëmonedhat e falsifikuara nuk do të shkëmbehen. Kjo është arsyeja pse Bundesbank

rekomandon kontrollimin e kartëmonedhave dhe një kujdes të veçantë me to. Për shembull, pjesë të imazhit të printuar mund të ndihen nën gishta në pjesën e përparme të kartëmonedhave. Elementet e hologramit ndryshojnë. Rekomandohet gjithashtu të krahasoni një kartëmonedhë të dyshimtë me një që është padyshim origjinale dhe t'u kushtoni gjithmonë vëmendje disa elementëve të sigurisë.

Karakteristikat moderne të sigurisë së serisë së re të kartëmonedhave

Ata që janë përgjegjës për monedhën euro po punojnë tashmë për veçori të reja sigurie për ta bërë edhe më të vështirë

për kriminelët falsifikimin e kartëmonedhave. Anëtari i Bordit Ekzekutiv të Bankës Qendrore Evropiane (ECB), Fabio Panetta, tha në një intervistë në fund të majit: "Ne po punojmë për emetimin e një serie të re kartëmonedhash të teknologjisë së lartë për ta parandaluar falsifikimin". Gjatë krijimit të serisë së re të kartëmonedhave, BQE i lejon qytetarët e Evropës të thonë fjalën e tyre për ridizajnimin e kartëmonedhave: Evropianët mund të thonë fjalën e tyre deri në fund të gushtit të këtij viti. Për shembull: Kultura evropiane, zogjtë, lumenjtë ose duart mund të zgjidhen. Megjithatë, do të kalojnë edhe pak vite derisa këto kartëmonedha të arrijnë në duart e qytetarëve. (DW)

AKP-ja miraton listën e aseteve për shitje përmes likuidimit SHAL 63

PRISHTINË, 1 GUSHT - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës të rregullt në të cilën ka shqyrtuar agjendën me 9 pika dhe 29 nënpika. Bordi i AKP-së ka aprovuar planin e veprimtimit për adresimin e rekomandimeve të ZKA-së për pasqyrat financiare të AKP-së dhe fondeve në mirëbesim për vitin 2022. Gjithashtu u informua lidhur me raportin gjashtëmuajor të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të cilin e aprovoi sipas procedurave si dhe u informua dhe shqyrtoi raportimin e menaxhmentit të AKP-së lidhur me proceset dhe procedurat e periudhës paraprake mujore, si dhe raportin mujor për NSH Brezovica e cila është nën

administrimin direkt. Në këtë mbledhje, pas shqyrtimit dhe diskutimit të hollësishëm, Bordi i Drejtorëve miratoi raportin e dytë tremujor 2023 për Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti. Bordi, po ashtu, ka aprovuar disa plotësime-ndryshime në rregulla të tenderit dhe procedura të shitjes. Në vazhdim të kësaj mbledhje Bordi aprovoi listën e aseteve për t'u shpallur për shitje përmes likuidimit SHAL 63 të përbërë nga 40 asete. Për më tepër, me qëllim të ngritjes së inkasimit të të hyrave nga qiraja, Bordi lëshoi disa udhëzime për menaxhmentin për masat që duhet të merren ndaj borxhlinjve në mënyrë që



të krijohet një disiplinë në pagesën e qirave ndaj AKP-së. Bordi aprovoi shpërndarjen e përkohshme të pjesshme për

kreditorët e PEJ029 NSH "Ereniku" - Prodhimtaria Primare"- Gjakovë. Bordi, po ashtu, u njoftua me raportin

përfundimtar të mbylljes së procesit të likuidimit të NSH KB Fryti - Babush i Muhaxherëve - Lipjan i cili do të dërgohet në Dhomë të Posaçme të Gjykatës Supreme për mbyllje të ndërmarrjes. Në vijim u aprovua raporti i Komisionit për përcaktimin e statusit për ndërmarrjen SDR 1536, PRN208 Stacioni i Veterinës në Prishtinë me anë të të cilit u konstatua se këto asete bien në pronësi shoqërore. Bordi, po ashtu, miratoi një raport fillestar për iniciim të procedurës për shitje me negociim direkt i cili do t'u nënshtrohet procedurave të tjera të parapara me legjislacionin për t'u finalizuar shitja sipas raportit përfundimtar i cili do t'i paraqitet Bordit për aprovim.

Një gazetar i mirë duhet t'i "bëjë duart pis"



Nga David RANDALL*

Supozoj që pjesa më e madhe prej nesh nuk pret të arrijë suksese të mëdha në fillimin e karrierës së vet, dhe mendon se kënaqësitë do të vijnë më vonë. Kështu që, do të ishte pak e trishtuar nëse, po të rimendojmë jetën tonë në punë, ne vetëdijësohemi se gjënë për të cilën jemi më shumë krenarë, e kemi bërë në debutimin tonë. Por pikërisht kjo i ndodhi një reporteri që unë njoh. Shkruan për një gazetë kombëtare, dhe artikujt e tij janë botuar në gjithë botën.

Merret me tema të mëdha dhe lajme me rëndësi ndërkombëtare. Por, ai ka dyshimin se artikujt më të rëndësishëm të jetës, i ka shkruajtur dyzetë vjet më parë, kur ishte 25 vjeç dhe punonte për një të përditshme lokale. Gjithçka kishte nisur kur një i pastrehë ishte gjetur i vdekur në stolin e një parku, në një qytezë në jug të Londrës, aty ku gazetari ynë po bënte praktikën në një të përditshme. Kishte shkruajtur një artikull dhe ia kishte propozuar kryeredaktores së tij. "Po endacakët vdesin vazhdimisht", i kish thënë ajo.

"Ku është lajmi këtu"?

Gazetari ishte përgjigjur: "Nuk është askush që të ndihmojë ata të gjojë. Ky nuk është lajm? Ta hajë dreqi, jemi në 1976-ën!"

Në fund, artikulli ishte botuar dhe gazetari kishte nisur të pyeste se sa të pastrehë kishte qyteti. U ishte drejtuar autoriteteve kompetente, por këta kishin mohuar që të kishte të pastrehë. Kështu, bashkë me një mikun e tij, kishte vendosur të dilte vetë netëve, për t'i kërkuar. Kishin shkruar në vendparkime, në banjot publike, në shtëpitë e braktisura, në parqe dhe kishin gjetur disa dhjetëra. Gazetari i ri kishte shkruajtur një tjetër artikull, dhe kur ishte botuar, famulltari i qytezës kishte sfiduar atë dhe mikun e tij, që të mos ndaleshin vetëm tek të folurit dhe të shkruarit, por edhe të bënin diçka.

"Të bëj?", kishte menduar gazetari. "Gazetarët nuk bëjnë, por shkruajnë". Por prifti kishte këmbëngulur, kështu gazetari kishte shkruajtur një tjetër artikull, duke i ftuar të gjithë qytetarët që donin të ndihmonin të pastrehët, që të merrnin pjesë në një takim.

Në takim ishin paraqitur rreth 25 vetë. Kishin themeluar një ent bamirësie të quajtur

"Nightwatch", që angazhohej për të sjellë supë të ngrohtë gjatë tre netëve të javës, si dhe panine apo të tjera gjëra, për të cilat të pastrehët kishin nevojë. Gazetari i ri në moshë ishte një prej tyre, dhe më vonë do të bëhej president i organizatës.

Mundem ta rrëfej këtë histori me një farë sigurie, sepse ai gazetari isha unë vetë. Kohët e fundit mora pjesë në fetimet e përvjetorit të dyzetë të entit të bamirësisë. Tani shpërndarja e gjellëve të ngrohta bëhet shtatë ditë në javë. Në këta vite, organizata ka ndihmuar qindra persona që të gjejnë një shtëpi, një punë apo ndihmë mjekësore për problemet e tyre mendore, si dhe të varësisë nga drogat.

Ka hapur një hostel, ka ndihmuar migrantët pa shtëpi dhe ka themeluar një tjetër organizatë për të pastrehët nën moshën 25 vjeç, që përveç kujdeset për mijëra të rinj e të reja në Londër. Ndërkohë që isha ulur aty e dëgjoja gjithë këto gjëra, nuk mund të mos mendoja që, asnjë prej artikujve të mi, apo fushatave në të cilat kam marrë pjesë, nuk ka patur një efekt konkret, si ato radhë që kisha shkruar për të pastrehët, 40 vjet më parë.

Përse?

Pothuaj të gjithë ato gjëra që ne gazetarët bëjmë dhe për të cilat jemi krenarë, në afat gjatë nuk kanë shumë rëndësi. Në momentet tona të marrëzisë më të madhe – dhe kemi shumë të tilla, ndonëse përlulesia nuk është karakteristikë e gazetarëve – mund të fantazojmë se autoritetet i studiojnë me vëmendje fjalët tona dhe se kjo, herët a vonë, do të prodhojë ndonjë farë ndryshimi në zgjedhjet e tyre.

Por është iluzion. Në kuptimin e efekteve konkrete, ajo që vërtetë ka rëndësi (përtej detyrës, thelbësore në një demokraci, të përhapjes së informacionit), është të shtyjmë lexuesit që të veprojnë. Dhe është më shumë e mundur që kjo të ndodhë nëse punon për një gazetë lokale, se sa një të tillë kombëtare.

Nismat e gazetave lokale shpesh herë ia dalin të shpëtojnë shkolla që rrezikojnë të mbyllen, të përmirësojnë shërbimet shëndetësore, të mbrojnë vende me interes historik, e kështu me radhë. Një gazetë apo radio lokale mund të shtyjnë publikun të veprojë, sepse mbulojnë një hapësirë mjaftueshëm të vogël,


sa t'u lejojnë njerëzve që duan të angazhohen, që të takohen dhe të bëjnë diçka. Asnjë e përditshme kombëtare nuk mund të bëjë një gjë të tillë. Nëse zhvendosesh nga një gazetë lokale në një gazetë kombëtare, ndoshta fiton më shumë dhe merresh me tema të një interesi më të përgjithshëm, por humbet shansin për t'i ndryshuar gjërat.

Morali i parë i historisë është që angazhimi lokal funksionon. Mos u qani për një problem në nivel kombëtar, përpikuni ta zgjidhni në nivel lokal.

I dyti është që, falë sfidës së atij priftit, në atë kohë unë vetë shkova kundër rregullave të gazetarisë, dhe u rrëmbeva prej lajmit. Në epokën e internetit, me botën e mbushur me njerëz që shkruajnë dhe komentojnë gjithçka, këto norma duken të kapërcyera tashmë. Gazetarët duhet të përfshihen më shumë. Sot jam 65 vjeç dhe me një tjetër organizatë bamirëse, po përpikem të imitoj veten time kur isha 25.

* David Randall ka qenë Kryeredaktor i Independent on Sunday në Londër. Libri i tij i fundit është: "Trembëdhjetë gazetarë pothuaj të përsosur" / Në shqip nga Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



'Dardanët' vazhdojnë stërvitjet në Prizren

PRIZREN, 1 GUSHT - Pas fitores ndaj Zvicrës, basketbollistët e Kosovës të martën kanë vazhduar stërvitjet në palestrën "Sezai Surroi" në Prizren. Përgatitjet do të vazhdojnë deri më 5 gusht, kur do të përballen me Danimarkën. Kjo është sfida e fundit në Rrethin e Tretë Parakualifikues, ku do të mësohet se kush do të

depërtojë më tutje. Ndeshja me Danimarkën cilësohet finale, ndërsa FBK-ja i ka ftuar të gjithë adhuruesit e basketbollit t'i përkrahin lojtarët e Kosovës, pasi është një nga takimet më të rëndësishme vitet e fundit. Përballja zhvillohet nga ora 20:45 më 5 gusht. Momentalisht Danimarka ka dy fitore, Kosova dy fitore

e një humbje dhe Zvicra tri humbje. Danimarka dhe Zvicra do të përballen më 2 gusht. Nëse danezët fitojnë këtë sfidë, "Dardanët" duhet ta mposhtin Danimarkën me tetë pikë dallim. Kosova mundi dy herë Zvicrën, 76:49 dhe 72:76, ndërsa pësoi nga Danimarka 82:75.



Klubet evropiane në 'gjah' për futbollistët e Kosovës

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 GUSHT - Ish-anëtari i Ballkanit, Ermal Krasniqi, nuk është i vetmi futbollist nga Kosova që po kërkohet nga skuadrat evropiane, pasi në këtë listë janë edhe anëtarët aktualë të Ballkanit, Albion Rrahmani dhe Armend Thaqi. Pas interesimit nga klubet arabe e ato jug-koreane, thuhet se futbollistin nga Malisheva, që është pjesë e Clujit, Ermal Krasniqi, po e kërkon edhe skuadra e njohur franceze Bordeaux. Mediumi rumun "ProSport" raporton se skuadra e Clujit ka marrë ofertë zyrtare për Krasniqin nga skuadra franceze në vlerë prej 2 milionë eurosh, por shuma që kërkon skuadra rumune është tre milionë euro. Negociatat janë duke vazhduar dhe Krasniqi mund të luajë në Ligën 1 në sezonin 2023/2024. Siç dihet

Krasniqi nga Ballkani iu bashkua skuadrës së Clujit dhe falë paraqitjeve të mira, ofertat për të janë me bollëk. Ndërsa futbollisti i radhës që mund të kalojë në futbollin evropian është Albion Rrahmani. Për këtë të fundit raportohet se Rapidi i Bukureshtit ka ofruar 600 mijë euro, një shifër rekorde kjo për futbollin e Kosovës. Rrahmani si me fanellën e Malishevës ashtu edhe me atë Ballkanit ka dëshmuar se është një sulmues më të ardhme të ndritur, për çka ka marrë ftesë edhe nga Përfaqësuesja e Kosovës. Futbollisti i radhës që mund ta braktisë futbollin e Kosovës është Armend Thaqi. Për anësin e Ballkanit interesim ka treguar Sivasspori, por gazeta mëson se tash për tash asgjë konkrete nuk ka. Thaqi është një prej lojtarëve më të mirë në vitet e fundit në futbollin e Kosovës, madje paraqitjet e tij edhe në garat



evropiane kanë qenë në nivel të lartë. Ditë më parë është raportuar se edhe mesfushori i kampionëve

të Ballkanit, Lindon Emerllahu, është duke u kërkuar nga skuadra bullgare Ludogorets. Por interesim

për njërin prej lojtarëve më të mirë ka edhe nga skuadrat austriake dhe polake.

Tjetër vlerësim i Federatës Ndërkombëtare për FHK-në, në Istog mbahet 'IHF Trophy'



PRISHTINË, 1 GUSHT - Federata Ndërkombëtare e Hendbollit (IHF) vazhdon ta vlerësojë shumë lart Federatën e Hendbollit të Kosovës. Në vazhdim të thellimit të bashkëpunimit, IHF-ja ia ka besuar Federatës së Kosovës organizimin e garës së rëndësishme "IHF Trophy" në konkurrencën e hendbollisteve. "IHF Trophy" për zonën evropiane do të organizohet për grupmohën U17 dhe U19. Pos Kosovës pritet të marrin pjesë

edhe Shqipëria, Andorra, Armenia, Azerbajxhani, Bosnjë-Hercegovina, Bullgaria, Gjeorgjia, Britania e Madhe, Moldavia, Malta. Kjo ngjarje e rëndësishme, që është edhe kualifikuese për Botëror, mbahet prej 11 deri më 15 tetor në palestrën e qytetit në Istog. Deri atëherë palestra në Istog pritet të rinovohet dhe të jetë plotësisht e gatshme. Fituesit e zonës evropiane kualifikohen për fazën ndërkontinentale. Dhe fituesit e garës ndërkontinentale sigurojnë biletën për në Botëror.

Përfaqësueset e Kosovës do ta kërkojnë suksesin në këtë ngjarje. Kombëtarja U17 e ka pas disa ditësh Evropianin dhe do të jetë e komponuar për "IHF Trophy". Ndërkohë Kombëtarja U19 tashmë e ka përfunduar Evropianin dhe e ka përvojën e duhur. FHK-ja prej fillimit ishte partnere serioze e IHF-së. "IHF Trophy" është organizuar edhe më parë në vendin tonë, ndërsa Federata e Kosovës është shquar si organizatore shembullore edhe e shumë ngjarjeve të tjera.

Uta Ibrahim: Jam e lumtur që po i vendos flamujt e mi të dashur nëpër çatitë e botës

Prishtinë, 1 gusht - Alpinistja nga Kosova, Uta Ibrahim, ditë më parë u ngjiti në majën e dytë më të lartë në botë, por të parën për nga vështirësia. Ajo

me këtë rast i ngriti lart flamurin kombëtar dhe atë shtetëror të Kosovës, ndërsa nuk mundi t'i mbante lotët pas kësaj arritjeje të

jashtëzakonshëm. Uta ka thënë se për të arritur deri këtu ka punuar dhe ka sakrifikuar shumë, por që ia ka vlejtur në fund. "Jam e lumtur që

sadopak po e lartësoj vendin tim - Kosovën dhe po i vendos flamujt e mi të dashur nëpër çatitë e botës", ka shkruar Uta Ibrahim.



Shaqiri shënon nga goditja e lirë dhe penalltia

CHICAGO, 1 GUSHT - Ylli shqiptar Xherdan Shaqiri ka shënuar edhe dy gola të tjerë me fanellën e klubit nga Mayor League Soccer, Chicago Fire. "Magjistari" nga Gjilani ka vazhduar paraqitjet e mira në ShBA,

duke shënuar edhe në ndeshjen e tretë nga katër të fundit. Pas një supergoli nga distanca para dy javësh ndaj Montrealit dhe një penalltie me klasë ndaj Minnesotas, Shaqiri ka gjetur përsëri portën. Shaqiri

ka shënuar dy gola gjatë ndeshjes së zhvilluar ndaj Pueblas në mëngjesin e së martës, duke u zgjedhur edhe lojtari më i mirë i ndeshjes. Goli i parë i Shaqirit erdhi në goditja e dënimit në minutën e 79 dhe

ishite goli i barazimit 1-1, rezultat që dërgoi ekipet në ekzekutimin e penalltive. Në penallti, djaloshi gjilanas ishte përsëri i saktë duke shënuar për skuadrën e tij, por kjo nuk i ndihmoi ekipit, pasi në fund u mposht.



Vazhdon rënia e Januzajt, pritet të kalojë te Cadizi

CADIZ, 1 GUSHT - Dështoi te Sevilla e shumë i suksesshëm nuk u shfaq as tek Istanbul Bashakshehiri. Kështu Adnan Januzaj po bëhet gati për tjetër lëvizje në karrierë. Sulmuesi i krahut me shumë mundësi do të bëjë tjetër hap prapa në karrierë. Mediume të shumta në Spanjë kanë shkruar se Januzaj do të transferohet te Cadizi. Cadizi vlerësohet prej skuadrave të vogla në La Liga. Në edicionin e kaluar luftoi për mbetje në elitën spanjolle, ndërsa përfundoi në vendin e 14-t me 42 pikë. Kishte dy pikë më shumë se Valladolidi që u largua nga La Liga. Një dekadë më parë pakkush mund të ketë menduar që Januzaj në moshën më të mirë do të bëhej gati për transferim te një ekip si Cadizi. Si supertalent, ai i ishte bashkuar Manchester Unitedit në moshën 16-vjeçare në mars të vitit 2011. Në edicionin 2013/14 kishte luajtur 27 ndeshje në Premierë Ligë për Unitedin dhe kishte shënuar katër gola. Vazhdoi të luajë me Unitedin edhe në edicionin 2014/15 e 2015/16. Potenciali i kosovarit vlerësohej shumë i madh. E ardhmja e ndritur. Por zhvillimi i Januzajt nuk ishte ai që pritej. Kishte një periudhë jo të suksesshme huazimi te Borussia Dortmundi në edicionin 2015/16. Më pas huazim luajti te Sunderlandi në Premierë



Ligë. Në verën e vitit 2017 Manchester Unitedi hoqi dorë përfundimisht nga Januzaj. Ai firmosi për pesë vjet me Real Sociedadin në La Liga të Spanjës. Te kjo skuadër ka luajtur goxha shumë, por nuk është se shkëlqeu. Sociadadi e liroi verën e kaluar dhe Januzaj firmosi për katër vjet me Sevillan. Por te kjo skuadër pati telashe të mëdha me hapësirë. Luajti vetëm dy ndeshje në La Liga. Në fillim të shkurtit u huazua në Superligën e Turqisë te skuadra Istanbul Bashakshehir. Në 11 ndeshje kampionale shënoi dy gola dhe i kishte tri asistime. Huazimi përfundoi në verë dhe Januzaj tani zyrtarisht është pjesë e Sevillas. Por jo edhe pjesë e planeve të skuadrës për kampionatin e ardhshëm. Ai nuk u përfshi në skuadër për një

turne përgatitor. Januzaj te Cadizi mund të kalojë në formë huazimi. Paga e Januzajt mund të ndahet nga Sevilla dhe Cadizi, me kusht që pas një viti 28-vjeçari të transferohet te Cadizi për 3 milionë euro. "Nuk do të ishte ndonjë hap para, por të paktën Januzaj do të kishte hapësirë e duhur për lojë", ka shkruar sajti belg "voetbalnieuws". Januzaj ka kohë që nuk po ftohet as nga Belgjika. Nuk ishte grumbulluar për Botërorin e kaluar. Ai mbetet me 15 paraqitje e një gol me përfaqësuese. Një dekadë më parë Januzaj i premtonte e ardhme e madhe te Manchester Unitedi. Aktualisht është jashtë planeve të Sevillas dhe rrugës drejt një skuadre edhe më të vogël spanjolle. Periudha e shkëlqimit si i ri tek Unitedi tashmë duket shumë e largët.

Hamiltoni befasohet nga Red Bull: Për ta dhe Verstappeni çdo gjë duket e thjeshtë

LONDËR, 1 GUSHT - Sezoni 2023 i Mercedesit dhe Lewis Hamiltonit është me luhate tek gara e fundit në Belgjikë tregoi edhe një herë se makina gjermane nuk është në nivelin që pritej. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 u rendit i katërti, duke mos pasur mundësi të duelojë as me Ferrarin. "Nuk afrohem dot me Red Bullin, ndërkohë që në Belgjikë edhe Lelcerc ishte më i shpejtë se ne. E vetmja gjë që mund të bëja në pistën e SPA ishte ta merrja pikën e xhiros së shpejtë dhe ia dola mbanë", u shpreh Hamiltoni. "Verstappeni ishte i pakapshëm në pistë këtë vit, ka krijuar një diferencë të madhe me të gjithë të tjerët, përfshirë edhe shokun e tij të skuadrës. Çdo gjë duket kaq e thjeshtë për të dhe Red



Bullin. Nuk e kuptoj këtë diferencë në kohët që japin në pistë me çdo tip gomash dhe kushtesh", ka deklaruar Hamiltoni. "Ne nuk jemi në gjendje të duelojmë për titullin këtë vit. Kemi shumë luhate në paraqitjet tona. Kjo makinë nuk ka bërë shumë

hapa përpara, ndaj është më mirë të përqendrohemi tek e ardhmja. Duhet shumë punë për ta çuar makinën në drejtimin e duhur. Të përiqemi ta ruajmë vendin e dytë në garën për konstruktorë", ka pohuar Hamiltoni.

SHKURT

Cana ofron mbështetje për KF Vëllaznimi

Legjenda shqiptare e futbollit Lorik Cana e ka vizituar skuadrën e Vëllaznimit nga Gjakova. "Kuqezinjtë" vlerësuan se vizita e Canës u jep motiv për të punuar në avancimin e sportit, kurse këshillat dhe mbështetja e tij u vlerësuan si vlerë e shtuar për klubin kuqez. "Kryesia e KF Vëllaznimit ka pritur në takim legjendën e futbollit mbarëshqiptar Lorik Cana. Vizita e tij na jep motiv dhe kurajë për të punuar në avancimin e sportit tonë, ndërsa këshillat e Lorikut dhe mbështetja e tij do të jenë vlerë e shtuar për ne. Ish-kapiteni i Kombëtares Shqiptare ofroi mbështetje të vazhdueshme për kryesinë e klubit dhe objektivat për të ardhmen e KF Vëllaznimit, duke theksuar se gjithmonë ka pasur marrëdhënie të mira me klubin kuq e zi", thuhet në njoftimin e skuadrës së Vëllaznimit.

Ronaldo thyen edhe një rekord

Edhe pse në moshën 38-vjeçare, Cristiano Ronaldo vazhdon të thyejë rekorde, madje në Arabinë Saudite. Legjenda portugeze shënoi në fitoren që Al Nasri arriti përballë Monastirit me rezultatin 1-4. Ky gol e futi në histori portugezin duke thyer rekordin e Gerd Mullerit për më shumë gola të shënuar me kokë, duke i bërë i pari për realizime të tilla me 145 të tilla. Gjithashtu, ai ka arritur një tjetër statistikë interesante duke shënuar në 22 sezone radhazi.

Mane pas kalimit tek Al-Nassri: Doja tjetër largim nga Bayerni

Sadio Mane tashmë konsiderohet ish-futbollist i Bayern Munchenit, duke qenë se zgjodhi të kalonte në Arabinë Saudite te skuadra e Cristiano Ronaldos, Al-Nassr. Në vigjilje të aventurës së re, ka vend edhe për keqardhje te senegalezi i cili në një prononcim për "Sky Deutschland" shprehet se dëshironte një tjetër fund për kapitullin e tij me Bayernin. "Ndihehem keq që po largohem në këtë formë nga Bayerni. Do të dëshiroja shumë që të kisha një tjetër fund me këtë klub. E di që mund ta kisha ndihmuar shumë skuadrën në sezonin e ri. Prisja një nga ato sezone ku të tregojta të gjithë vlerat e mia, por tani ka ardhur fundi. I uroj klubit dhe tifozëve të Bayernit më të mirat", u shpreh Mane.

Calhanoglu: Duam ta fitojmë 'Scudetton'

Mesfushori turk i Interit, Hakan Calhanoglu, ka thënë se skuadra nënkampione e Evropës është duke u përgatitur mirë dhe se në sezonin e ri synon titullin e kampionit në Serinë A. "Këtë sezon duam ta nisim në mënyrën më të mirë të mundshme. Jemi maksimalisht të përqendruar te kampionati dhe te titulli. Ka disa skuadra të forta në Itali, por jemi të përgatitur për të qenë në krye të klasifikimit. Në këtë skuadër ka shumë lojtarë me kultura të ndryshme, por ne jemi të bashkuar. Ndihehem si një familje e madhe. Janë të gjithë djem shumë të mirë. Këtu tek Interi kur vjen një lojtar i ri, bashkohemi të gjithë dhe përpiqemi ta ndihmojmë me gjithçka. Si brenda fushës, ashtu edhe jashtë saj", ka thënë Calhanoglu.

Fabinho paraqitet tek Al-Ittihad

Klubi nga Arabia Saudite, Al-Ittihad, njoftoi të hënën për marrëveshjen me një video të titulluar "tigrat lejohen të kalojnë" përpara se të pasonin

fotot zyrtare të lojtarit me klubin së bashku me mbishkrimin: "Mirë se erdhe Fabinho në fortesën e tigrave!". Videoja e njoftimit i referohej një problemi

të përfolur në marrëveshje, që përfshinte shqetësimin e Fabinhos për qentë e tij. Fillimisht u pretendua se lojtari kundërshtoi rregullat në

Arabinë Saudite që ndalonin 'qentë e rrezikshëm dhe agresiv' pasi ai zotëronte dy bulldogë, megjithëse histori të tilla dolën të pabaza. 29-vjeçari

ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2026, ku do të përfitojë 25 milionë euro në vit. Brazili deri më tani ishte pjesë e klubit të Liverpoolit.



Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 03/ L -212 të Punës të Republikës së Kosovës ,vendimit të Këshillit Drejtues të datës 24/07/2023 dhe nenit 5 të UA nr 7/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik , Oda e Farmacistëve shpall këtë :

Konkurs Publik

Nr references	01/2023
Emri i Institucionit:	Oda e Farmacistëve të Kosovës
Titulli i punës:	Zyrtar për financa dhe administratë
Koeficienti i pagës:	Me marrëveshje
Raporton te:	Sekretari i Përgjithshëm
Lloji i kontratës:	Kohe të caktuar deri me 01/12/2024 - Zëvendësim pushim me Mundësi vazhdimi
Numri i ekzekutuesve	1 (një)
Vendi:	Prishtinë

Detyrat kryesore:

- Përkujdesjen për llogaritjen e meditjeve dhe pagave të organeve dhe shërbimit profesional në OFK në baza mujore
- Mban evidencat e pjesëmarrjes në takimet e OFK-së
- Përkujdeset për ruajtjen e faturave të shërbimeve pranuar nga OFK sipas datave dhe kërkesave të furnizimeve dhe përcjell për ekezekutim te zyrtari financiar-kontabilisti
- Pranon kërkesat për kompenzimin dhe lejimin e udhëtimeve jashtë vendit në emër të OFK-së
- Përkujdeset për kërkesat e organeve të OFK-së të cilat përfshijnë kosto financiare për dërgim dhe aprovim
- Përcjell gjendjen mbi përmbushjen e taksës administrative për anëtarësim nga anëtarët e OFK-së
- Ofron mbështetje administrative për punën e organeve
- Kryenë punë tjera profesionale të caktuara nga mbikqyrësi

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara për vendin e punës :

- të këtë kryer Fakultetin Ekonomik;
- 1 vite përvojë pune në profesion;
- Njohja e punës me kompjuter në softuer të nevojshëm për kryerjen e punëve (përparësi kandidatët me dëshmi përkatëse)
- Gatishmëri dhe aftësi për të bashkëpunuar dhe për të mbajtur marrëdhënie të mira bashkëpunimi në harmoni ndërkollegiale
- Përvoja e punës është përparësi

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Aplikacioni mund të shkarkohet në ëeb faqen e OFK-së www.ofk-rks.net apo mund të merret edhe në zyrat e OFK-së

Dorëzimi i aplikacioneve: Zyra administrative e OFK-së rr.Qamil Bala, Hyrja 8, Dera nr 34

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni në numër telefoni 048 572222, prej orës 09:00 – 14:30 ose email adresën info@ofk-rks.net

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit, që nga data: 02/08/2023 deri më 16/08/2023, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkohen vendi i punës dhe aplikacioni.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Cjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leon Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Shkurte Islami shpall të pavlefshme dëftesat diplomën si dhe certifikatën e testit të maturës të Gjmnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

- "Prime Group Constructione" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nrb. 810046781.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA
ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 594 /1
Dt: 01.08.2023

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ 05/2015, Udhëzimit Administrativ 07/2017, Vendimi (MASHTI) nr. 01B/027 të dt. 03.03.2023, Vendimi (MASHTI) nr. 326/01B të dt. 28.07.2022, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

SHPLLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira dhe zëvendësim në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Prizren për vitin shkollor 2023/2024

Niveli	Institucioni/Shkollë	Vendi	Pozita/Vend i lirë	Vend i lirë/Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë	Malishevë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën Instalues i ngrohjes me klimatizim dhe ujësjellës e kanalizim (20 orë mësimore);	Zëvendësim deri në kthimin e mësimdhënës nga pushimi i
SHML	Qendra e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi”, në Prishtinë	Prishtina	Dy (2) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Esteticient/e”, me nga 20 orë;	Vend i lirë
SHML	Qendra e Kompetencës	Prizren	Një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Esteticient/e”, 10 orë; Një (1) Instruktor /e për modulet profesionale të profilit “Floktari”, 10 orë	Vend i lirë Vend i lirë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.

- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës në arsim (nëse ka);
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Detyrat dhe Përgjegjësitë për Instruktor:

- Instruktori është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e teorisë dhe praktikës profesionale.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të praktikës profesionale dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjisllacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrën Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për instruktor:

- Diploma e përgatitjes profesionale përkatës sipas UA (MASHTI), niveli i 6 sipas KKK;
- Instruktor profesional me kualifikim: post sekondar, arsim të mesëm të lartë;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit “Esteticient/e”, përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Për modulet e praktikës profesionale të profilit “Floktari”, përparësi kanë kandidatët me përgatitje/ kualifikim Bachelor, niveli i V ose ekuivalent, me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në fushën përkatëse;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës së punës;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;

Procedurat e konkurrimit:

- Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, në Qendrën e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, dhe Qendrën e Kompetencës në Prizren.
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.
- Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1909

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
0.5L